



SBUNKER POLICY BRIEFS

POLICY BRIEF #3

Procesi i anëtaresimit të Kosovës në NATO

Autorë: Dr. Florian Qehaja dhe Agon Maliqi



Mbështetur nga:



Prishtinë, Dhjetor 2020

PËRMBLEDHJE

Synimi strategjik i Kosovës për integrim në NATO vijon të jetë i palëkundur. Ky synim nuk mbetet vetëm i reflektuar në dokumente strategjike dhe në narracionin zyrtar të Kosovës, por edhe mbështetja popullore për anëtarësim është e paprecedentë për rajonin – mbi 90% e respondentëve në vazhdimësi janë pro anëtarësimit.¹ Pavarësisht kësaj, ka një diskrepancë faktike në mes aspiratës së Kosovës për anëtarësim dhe faktit se NATO vazhdon ta shoh vendin tonë nga prizmi strikt i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (KS) të Kombeve të Bashkuara (KB). Kjo sidomos për faktin që katër shtete të NATO-s – Spanja, Sllovakia, Rumania dhe Greqia – ende nuk e kanë njohur formalisht Kosovën. Në rast se dështon dialogu në mes Kosovës e Serbisë, atëherë gjasat e Kosovës për anëtarësim do të eliminoreshin, sepse NATO e ka bërë të qartë se me padurim pret rezultatin e dialogut, dhe se vetëm një marrëveshje në mes Kosovës e Serbisë do të shpiente në njohjet nga 4-shja ekzistuese.

Ky dokument e ravijëzon rrugëtimin e Kosovës për anëtarësim në NATO, në rast se: a) arrihet një marrëveshje në mes Kosovës e Serbisë dhe; b) do të zhbllkoheshin katër njohjet nga shtetet mosnjohëse të NATO-s. Trajektorja e anëtarësimit do të ishte si më poshtë:

- Pas shprehjes së interesit dhe aplikimit formal, Kosova do të mernte zotim nga Këshilli i Aleancës Veriatlantike se vendi do të anëtarësohet në një të ardhme të afërt. Ky zotim do të bëhej në një mënyrë formale, mbase duke e shmangur aderimin tradicional në programin Partneritet per Paqe për vet faktin se Kosova me automatizëm i përmbush kriteret;
- Hapi i radhës dhe ai kryesori do të ishte dizajnimi i Planit të Veprimit për Anëtarësim (PVA) ku në kuadër të saj do të hynin dy lloj kriteresh kryesore: politike dhe ushtarake. Në kuadër të kriterëve politike do të mund të hynin një gamë e gjerë nën-kriteresh të cilat do të konsistonin në zbatimin e çështjeve politike në raport me Serbinë, demarkimin e kufijve, konsolidimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Kriteret ushtarake janë më të parashikueshme, pasi që ato në masë të madhe do të mund të ishin brenda fushëveprimit të procesit ekzistues të tranzicionit të FSK-së nga një mandat civil në atë të mbrojtjes (siç parashihet me Planin Gjithpërfshirës të Tranzicionit të FSK-së 2018-2028);
- Miratimi i kriterëve të zbatuara të PVA nga kreu i NATO-s do të shpiente në procesin formal të ftesës së Kosovës për t'u bërë anëtare, ftesë kjo e cila do të pasohej me ratifikimin e traktatit për anëtarësim nga 30 shtetet anëtare ekzistuese të NATO-s;
- Pavarësisht se është vështirë të vendosen afatet kohore, Kosovës do t'i duheshin optimalisht 7 vite për t'i plotësuar kriteret e NATO-s, gjykuar këtu nga përvoja e shteteve tjera por edhe nga procesi tashmë i dizajnuar i tranzicionit të FSK-së në një mandat të mbrojtjes;
- Edhe në rast të eliminimit të barrierave politike, Kosova do të mund të sfidohej nga pozicioni individual i disa shteteve, për shkak se vendim-marrja në NATO bëhet me konsensus. Duke qenë në dijeni se disa shtete anëtare nuk do të donin ta "iritonin" Serbinë me ofrimin e anëtarësimit për Kosovën në NATO, ekziston rreziku për një skenar alternativ sipas modelit të Ukrainës, ku do të bëhej një partneritet strategjik (Enhanced Opportunity Partnership) mes NATO-s dhe Kosovës pa anëtarësim të plotë – rrezik ky të cilin Kosova gjithsesi duhet ta shmang.

SFONDI I QËLLIMIT STRATEGJIK PËR INTEGRIM NË NATO

Në konstalacionin ekzistues, konsolidimi ndërkombëtar i Kosovës ka arritur pikën kulminante. Trajektorja e integrimit të Kosovës në sistemin ndërkombëtar – në kuadër të njohjeve ekzistuese nga shumica e thjeshtë e shteteve anëtarë të OKB-së – do të mund të kornizohet në integrimin maksimal në organizatat ndërkombëtare që kërkojnë shumicë të thjeshtë për anëtarësim e eventualisht ato të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar gjë që Kosova nuk arriti këtë synim në UNESCO dhe INTERPOL. Sukseset e viteve të para u shënuan në kuadër të organizatave ndërkombëtare financiare por edhe ato të sportit megjithatë mësyemja e Kosovës drejt integrimit në organizata tjera hasi në një rezistencë të paskrupullt nga Serbia, sidomos nga viti 2015 e këndej.² Paralelisht, përkrahja ndërkombëtare u zbeh jo vetëm për shkak të një "lodhje" të shfaqur nga partnerët e Kosovës por edhe për shkak të rritjes së populizmit tek shtetet perëndimore të cilat në shumicën e rasteve kishin pozicion hezitues nëse jo kundërshtues ndaj Kosovës. P.sh partitët populliste gjetiu sfidojnë, mes tjerash, rendin liberal botëror mbi bazën e së cilës u krijua edhe shteti i Kosovës.

Tashmë kur dihet se çelësi i integrimit të Kosovës në sistemin ndërkombëtar gjendet në një zgjidhje eventuale të kontestit mes Kosovës e Serbisë, vendi vështirë se mund të llogarisë në integrim në organizata ndërkombëtare në rast të dështimit zyrtar të dialogut. Skenari i dështimit të dialogut – i kornizuar ndryshe si skenari i zyrtarizimit të "konfliktit" të ngrirë" – do ta vendoste Kosovën në një pozicion mbijetese pa perspektivë zhvillimore.³ Në kuadër të këtij skenari, Kosova do të varej nga partneritetet bilaterale duke investuar fort në mirëmbajtjen e tyre dhe eventualisht zgjerimin me partnereët tjerë jashtë Evropës, sidomos në fushën e mbrojtjes e ekonomisë. Krahas kësaj, vendit do të duhej të shfrytëzonte edhe më tutje prezencën e KFOR-it për interesa të saja edhe pse prezenca ndërkombëtare ushtarake si e tillë vijon së ushtruar misionin në përputhje me Rezolutën praktikisht të vjetëruar të Kombeve të Bashkuara 1244.⁴

Duke lënë anash skenarin e mos-arritjes së marrëveshjes dhe me pritjen se do të mund të arrihej ndonjë marrëveshje në mes Kosovës e Serbisë, synimi i fortë strategjik për anëtarësimin në NATO do të mund të jetësohet. Integrimi në NATO vazhdon të mbetet një aspiratë e theksuar shprehimisht në dokumente zyrtare megjithatë kjo vështirë se do të mund të arrihej pa sigurimin e njohjeve ekzistuese nga shtetet e mbetura të NATO-s. NATO vazhdon ta sheh në mënyrë të ngurtë Kosovën: është një nga organizatat ndërkombëtare (së paku krahasuar me BE-në) e cila në mënyrë strikte dhe pa ekuivoke i referohet Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të KB-së 1244. Ajo si e tillë (pra në suaza të 1244) e sheh jo vetëm misionin e saj të KFOR-it por edhe Kosovën, së paku në terma formal. Negjithëse në aspektin jo formal ajo ka ndërveprim me institucionet e shtetit të Kosovës përfshirë dhe me instrumentet kryesore të shtetit siç janë: Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Jashtme. Kosova të arriturën e vetme me NATO-n e ka pasur një letër-këmbim në vitin 2015 në mes Sekretarit të NATO-s Stoltenberg dhe ish Kryeministrit Mustafa. Ky letër-këmbim, vendosi një kornizë të ngushtë të ndërveprimit në mes të NATO-s dhe Kosovës e cila kornizohet në fushat siç janë: reagimi emergjent, ndërtimi i integritetit, vizitat studimore etj.⁵ Ky ndërveprim si i tillë ka limite dhe pothuajse është zbatuar në dy vitet e para.

Tani pyetja shtrohet se si do të zhbllokohej rrugëtimi i Kosovës drejt NATO-s nëse do të arrihej marrëveshja në mes Kosovës e Serbisë? Sigurisht se për këtë lypset një shpjegim më kompleks në një situatë hipotetike megjithatë përgjigja e shkurtër dhe e thjeshtë do të ishte rreth asaj se a do t'i zhbllokonte kjo marrëveshje

njohjet nga shtetet evropiane si: Spanja, Sllovakia, Rumania, Greqia dhe Qipro.⁶ Shumica e këtyre shteteve kanë dhënë indikacione se pozicioni i tyre do të mund të arrihej në rast të ndonjë marrëveshje në mes Kosovës dhe Serbisë. Spanja, një prej vendeve më kundërshtuese të pavarësisë, e ka bërë të qartë së voni se do e pranoj çfarëdo marrëveshje mes dy vendeve,⁷ përderisa shtetet si Greqia e Sllovakia kanë dërguar sinjale akoma më të qarta në drejtim të njohjes pas ndonjë marrëveshjeje eventuale.⁸ Rumania do të mbetet e izoluar në rast të një zinxhiri njohjesh nga tre shtetet e përmendura kurse Qipro pritet të jetë problematike, gjithsesi në fronte tjera, sidomos në atë të integritimit në BE.⁹

HAPAT E PROCESIT

Në rast të arritjes së marrëveshjes e cila – siç thamë – do të prodhonte njohjen nga 4 shtetet e NATO-s apo marrëveshja si e tillë do të kishte si derivat kryesor integritimin e (përshpejtuar) të Kosovës në NATO, trajektorja e integritimit të Kosovës në këtë organizatë do të përfshinte një udhërrëfyes potencial si më poshtë:

Hapi i parë - Tejkalimi i Partneritetit për Paqe

Hapi i parë i anëtarësimit të secilit shtet në NATO ka qenë dhe – teknikisht vazhdon të jetë – aderimi në Programin e NATO-s "Partneritet për Paqe" (PpP). PpP është lansuar në vitin 1994 me qëllim të krijimit të partneriteteve të vendeve në tranzicion demokratik si dhe atyre në fqinjësinë e afërt me shtetet e NATO-s, duke ia trasuar rrugëtimin sidomos shteteve të ish-blokut të lindjes, që aderimin e tyre në këtë program të nisin zyrtarisht procesin e anëtarësimit në NATO.¹⁰ Për arsye politike dhe të mos-njohjes nga katër shtetet e NATO-s, Kosova vazhdon të jetë vendi i vetëm i cili nuk është pjesë zyrtare e PpP dhe as nuk përfiton nga fondet dhe aktivitetet që derivojnë nga ky program. Shtetet e fundit të cilat u bënë pjesë e PpP-së në Ballkanin Perëndimor ishin: Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia.¹¹ Vetëm kjo e fundit nuk është pjesë e NATO-s - pozicioni zyrtar i saj është ruajtja e "neutralitetit ushtarak", për shkak të bombardimeve të vitit 1999.

Pavarësisht se PpP vijon të jetë teorikisht hapi i parë për anëtarësim në NATO, në kohën në të cilën jemi, si dhe duke pasur parasysh prezencën e KFOR-it e cila do të mbetet (qoftë edhe simbolikisht) deri në anëtarësimin e plotë të Kosovës në këtë organizatë, Kosova me automatizëm do t'i plotësonte kushtet për të qenë pjesë e PpP. Shtetet e fundit të cilat aderuan në PpP duhej t'i përmbushnin kriteret bazike të themelimit të instrumenteve të kontrollit civil e mbikëqyrjes demokratike mbi sektorin e sigurisë, të cilat Kosova i ka dukshëm më të konsoliduara se shtetet përreth. Kjo për faktin se institucionet e Kosovës në mënyrë të njëanshme apo si pjesë e proceseve tjera kanë ndërtuar sektorin e sigurisë në kuadër të kuhsteve të kërkuara edhe nga NATO-ja.

Si alternativë e aderimit të Kosovës në PpP, debutimi i Kosovës në procesin e integritimit në NATO do të mund të bëhej me një zotim politik të shteteve anëtare në mbledhjen e Këshillit të Veri-Atlantikut (NAC) mbi bazën e së cilës do të konstatohej se NATO i ka dyert e hapura për Kosovën, mbase pas shprehjes formale të interesit për anëtarësim nga ana e qeverisë së Kosovës. Ky momentum, përveç se do të konsiderohej si pikënisje për anëtarësim, me automatizëm do t'i:

- a.) Lejonte Kosovës qasje në të gjitha programet e NATO-s, njëjtë sikurse shtetet jo-anëtare;
- b.) Hapte shtegun e çeljes së përfaqësisë së Kosovës në NATO, sipas modeleve të shteteve tjera jo-anëtare apo atyre që synojnë anëtarësim;
- c.) Do të niste procedurat për dizajnimin e udhërrëfyesit kryesor për anëtarësim – Planit të Veprimit për Anëtarësim (Membership Action Plan).

Hapi i dytë - Plani i veprimit për anëtarësim

Plani i Veprimit për Anëtarësim (PVA) do të përbente kornizën kryesore për anëtarësimin e Kosovës ku në kuadër të saj do të listoheshin një sërë kushtesh që vendi do të duhej të zbatonte për t'u integruar në NATO. Gjykuar nga përvoja e shteteve të tjera, kushtet do të ndaheshin në ato të karakterit politik dhe ushtarak. Secili shtet i ka pasur kushtet e veta specifike ("tailor-made conditions"). Megjithatë, duke u bazuar në skenarin e rëndimit me kushte për Kosovën në procesin e liberalizimit të vizave (krahasuar me shtetet tjera), e njëjta logjikë do të mund të na printe edhe në kuadër të PVA për NATO. Aktualisht në rajon, vetëm Bosnja e Hercegovina është në proces të PVA dhe ajo nuk ka arritur që ta përmbyllë këtë për shkak të bllokadës që vjen nga entiteti Republika Srpska.¹² Shtetet e tjera të cilat tanimë janë pjesë e NATO-s iu kanë nënshtruar ngjajshëm procesit nëpërmjet PVA.

Në rast se njohjet ekzistuese do të zhbllokoheshin, periudha kohore për zbatimin e PVA logjikisht do të duhej të përkonte me zbatimin e Planit të Tranzicionit të FSK-së, i cili për afat final ka vitin 2028. Periudha 7 vjeçare e zbatimit të PVA do të përbente një afat optimal për Kosovën dhe vet NATO-n.

Në kuadër të kushteve politike të cilat do të parashiheshin me PVA, do të mund të përfshiheshin një spektër i gjerë i kriterëve të cilat orientimisht do të kishin të bënin me çështjet si vijon:

- Zbatimi i marrëveshjes me Serbinë (pikat konkretet të karakterit politik e të sigurisë);
- Përfundimi i demarkacionit me Serbinë dhe marrja graduale e kompetencve nga KFOR-i për ruajtjen e kufirit nga Policia Kufitare e Kosovës;
- Konsolidimi i mbikqyrjes demokratike e kontrollit civil mbi FSK-në (mbase edhe revidimi i legjislacionit në fushë, nëse e domosdoshme);
- Mbrojtja e të drejtave të pakicave dhe garantimi i statusit për objektet e veçanta dhe ato të kultit.

Sigurisht se, në varësi të rrethanave, pjesa politike e PVA do të përfshinte disa nënkritere tjera, mbase në koordinim me BE-në dhe akterët e tjerë.

Në kuadër të kushteve ushtarake, gjendja është paksa më e qartë sepse kriteret do të përkonin në masë të madhe me tranzicionin e FSK-së në forcë mbrojtëse ashtu siç definohet me Planin Gjithpërfshirës të Tranzicionit (PGJT) të FSK-së. Pavarësisht se NATO ka mbajtur një pozicion neutral, nëse jo edhe kundërshtues lidhur me këtë proces, ekipi i saj brenda Ministrisë së Mbrojtjes në mënyrë indirekte ka qenë i përfshirë në këtë proces. Gjithsesi, shtetet kyçe të NATO-s, në nivel bilateral kanë kontribuar në përpilimin e PGJT dhe në zbatimin e saj. Këtu mendohet në shtete si SHBA, Britania e Madhe e deri diku edhe Gjermania.

Kriteret ushtarake do të mund të përfshinin por të mos kufizoheshin në këto të mëposhtmet:

- Zbatimi i të trija fazave të tranzicionit të FSK-së në një forcë mbrojtëse siç parashihet me PGJT (përfshirë këtu aspektet e ndryshimit të doktrinës; rekrutimit, gradimit dhe avancimit të personelit, si dhe arritjes së numrit prej 5000 pjesëtarëve aktiv e 3000 rezervë; fitimi i aftësive grupore të këmbësorisë e funksionalizimi i Regjimentit Luftarak; furnizimi me pajisje e armatim të këmbësorisë etj);
- Pjesëmarrja në misione paqëruajtëse në nivel të togut, potencialisht në misionin e NATO-s në Afganistan apo edhe mbështetja njësive mobile në rajonin e Baltikut;
- Krijimi i një qendre të ekselencës në një fushë të caktuar sipas modelit "mbrojtja e mençur" (smart defence), potencialisht në sferën e reagimit emergjent apo deminimit, gjykuar nga ekspertiza FSK-së e fituar në dy dekadat e fundit;
- Përafrimi me kriteret specifike të NATO-së dhe pjesëmarrja në programe respektive (P.sh Programi për Ndërtimin e Integritetit, Programi për Burime Njerëzore, Programi për Siguri, Programi Shkencë për Paqe, Prokurimi i Mbrojtjes etj);
- Regjistrimi i të gjitha pronave të ish Armatës Popullore të Jugosllavisë në territorin e Kosovës dhe eventualisht bartja e tyre në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes;¹³
- Pjesëmarrja në trajnimet e ofruara nga qendrat e NATO-s (krahas atyre bilaterale).

PVA si proces do të duhej të ngërthente një koordinim të drejtpërdrejt në mes të Ministrisë së Jashtme të Kosovës dhe selisë qendrore të NATO-s në Bruksel. Ministria e Mbrojtjes/FSK, prezenca e KFOR-it dhe Shtabi i NATO-s - SHAPE në Mons do të shërbenin si instrumente të dy strukturave koordinuese në funksion të zbatimit të PVA.

Faza e tretë - Ftesa zyrtare për anëtarësim dhe ratifikimi i traktatit nga shtetet anëtare

Organet për zbatimin e PVA do të konstatojnë zbatimin e të gjitha kriterëve të cilat do të konfirmoheshin në mbledhjen e Këshillit Veri-Atlantik në nivel të Ministrave të Jashtme. Si rrjedhojë, Kosovës do t'i bëhej ftesa për anëtarësim si anëtarja e 31-të e organizatës. Ka një përvojë të vogël të NATO-s në vlerësimin e kapaciteteve të FSK-së duke pasur parasysh miratimin e kapaciteteve të pjeshme (2011) dhe atyre të plota (2013)¹⁴ të cilat në mënyrë të tërthortë i hapen rrugë rishikimit të mandatit të FSK-së, bazuar edhe në mundësinë e ofruar nga Plani i Ahtisaarit.

Në rast të miratimit të PVA-së së zbatuar, hapi i fundit formal do të ishte ratifikimi i traktatit për ratifikim nga të gjitha shtetet anëtare të NATO-s. Këtu Kosova do të haste potencialisht në dy lloj vështirësi:

- Burokracia e disa parlamenteve evropiane do të vononte në muaj të tërë, nëse jo vite, ratifikimin e një traktati të tillë;

- Disa shtete do ta kushtëzonin në moment të fundit ratifikimin e marrëveshjes duke u bazuar në skenarin e anëtarësimeve të shteteve tjera jo vetëm në NATO por edhe në BE.

Barrierat potenciale në arritjen e synimit strategjik

Tejkalimi i barrierave ekzistuese politike për mosnjohjen nga 4 shtete të NATO-s nominalisht do të shpiente në drejtim të hapjes së rrugës për anëtarësim të Kosovës në NATO. Megjithatë, edhe pse Kosova do të mund të kishte kapacitete për t'i plotësuar kushtet në rast se ato do të ishin të përafërta me udhërrëfyesin e shteteve fqinje, probleme të natyrës tjetër do të mund të shfaqeshin. Do të mund të vërehej një disponim jo shumë i madh i ca shteteve anëtare të NATO-s që të pranojnë faktin se Serbia do vijojë pozicionin kundër anëtarësimit (si i tillë parashihet të mbetet) ndërkohë që Kosovës i ofrohet një rrugëtim i tillë.

Duke krijuar një analogji në pozicionin e NATO-s në raport me Ukrainën, aspirata ukrainase për anëtarësim në NATO është zbehur për vet faktin se NATO përveç se sheh kërcënim ushtarak nga Rusia dhe e merr seriozisht kundërshtimin e saj për anëtarësimin e Ukrainës, ajo ka vendosur që për një të ardhme të mos i ofrojë perspektivë anëtarësuese Ukrainës me qëllim që të mos e antagonizojë Rusinë. E njëjta logjikë do të mund të përdorej në relacionin në mes Kosovës e Serbisë ku disa shtete, duke u nisur nga mantra e "stabiliteti të ekzagjësuar" do të shprehnin skepticizëm për anëtarësimin e Kosovës në NATO, sepse nuk do të donin ta shihnin Serbinë të irituar nga ky veprim. Edhe në rast të ndonjë marrëveshje me Kosovën, Serbia gjithsesi do ta kundërshtonte rrugën për anëtarësimin e saj në NATO.

Në rast të forcimit të zërave të tillë, skenari ukrainas do të mund të jetësohej në Kosovë ku në vend të anëtarësimit do të ofrohej "Enhanced Opportunity Partners" si pjesë e "Partnership Interoperability Initiative". Ky partneritet i cili si i tillë është bërë nga NATO edhe me shtetet tjera si: Australia, Finlanda, Gjeorgjia, Jordania, Suedia dhe Ukraina¹⁵ do të mund të imponohej si një alternativë e anëtarësimit. Kosova do të duhej ta shmangte një skenar të tillë.

REKOMANDIME

Kosova duhet të vazhdojë me këmbënguljen për anëtarësimin në NATO si një aspiratë e ngulitur thellësisht në kontekstin historik, politik e të sigurisë së Kosovës. Gjasat që Kosova ta rrijë këtë objektiv janë të mëdha jo vetëm në rast të marrëveshjes eventuale me Serbinë por edhe duke u bazuar në faktin se NATO vazhdon të jetë e shqetësuar me rritjen e ndikimit të Rusisë dhe Kinës në Ballkan. Sado që anëtarësimi i Kosovës në NATO do të mund të shihej si një skenar më i mundshëm krahasuar me anëtarësimin në BE, janë disa aspekte të cilat duhet të konsiderohen. Rrjedhimisht ky dokument liston disa rekomandime për Qeverinë e Kosovës:

- Anëtarësimi i Kosovës në NATO si rezultat final (end result) do të duhej të gdhendej në kuadër të një marrëveshje eventuale në mes Kosovës dhe Serbisë. Qeveria e Kosovës duhet të insistonte që si një ndër derivatet e shpejta të marrëveshjes të jetë anëtarësimi i përsheptuar i Kosovës në NATO, duke

u bazuar në skenarin tani më të jetësuar të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO pas arritjes së marrëveshjes me Greqinë;

- Qeveria e Kosovës duhet të ketë të gatshme një propozim-udhërrëfyes për integrim të përsheptuar në NATO, në linja me atë se çfarë është sygjeruar në këtë dokument;
- Kapitali i politikës së jashtme do të duhej të orientohej, para së gjithash, në pozicionimin e zyrtarëve dhe individëve më të denjë të shtetit të cilët do të ishin në shërbim të këtij objekti. Këtu nuk mendohet vetëm në vendosjen e "zyrtarëve të duhur në vendin e duhur" brenda institucioneve të MPJ-së dhe MM-së, por edhe në përfaqësinë e Kosovës në NATO;
- Qeveria e Kosovës duhet të jetë në gjendje t'i analizojë rreziqet në rrugëtimin për integrim në NATO. Rreziqet të cilat do të shfaqeshin në proces e sipër do të duhej të minimizoheshin kurse rreziqet me qëllim shmangien apo deformimin e rrugëtimin të Kosovës në suaza të ndonjë partneriteti alternativ do të duhej të eliminoheshin që në fillim.

REFERENCAT

¹ Për më shumë, shih Barometrin Kosovar të Sigurisë ndër vite www.gkss.org

² Columbia University and KIPRED, "Threats and Challenges to Kosovo's Sovereignty," [http://www.kipred.org/repository/docs/ThreatsAndChallenges_Vers-FIN_\(1\)_94986.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/ThreatsAndChallenges_Vers-FIN_(1)_94986.pdf)

³ Florian Qehaja, "Towards which strategic end? Unpacking Kosovo's position in international system following potential agreement with Serbia" p.12

⁴ Për më shumë shih Rezolutën e KS të OKB <https://unmik.unmissions.org/united-nations-resolution-1244> Qasur me 18 nëntor 2020

⁵ Letter of NATO Secretary General, Jens Stoltenberg addressed to Kosovo's Prime Minister, Isa Mustafa, 5 December 2016, SG(2016)0357, 1

⁶ Qipro nuk është anëtare e NATO-s mirëpo është anëtare e BE-së.

⁷ Për më shumë shih <https://euobserver.com/enlargement/149467> Qasur me 24 nëntor 2020

⁸ Për më shumë shih <https://www.tiranatimes.com/?p=147453> Qasur me 22 nëntor 2020

⁹ Isabelle Ioannides, "Cyprus firmly committed to the non-recognition of Kosovo" in James Ker Lindsay and Ioannis Armatolas, *The Politics of Recognition and Engagement: EU Member State Relations with Kosovo* (London: Palgrave Macmillan, 2019) 214

¹⁰ NATO, Programi PpP https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_50349.htm Qasur me 19 nëntor 2020

¹¹ NATO, NATO fton Bosnje e Hercegovinën, Malin e Zi e Serbinë të bëhen pjesë e Programit PpP <https://www.nato.int/docu/update/2006/12-december/e1214a.htm> Qasur me 20 nëntor 2020

¹² Për më shumë shih <https://balkaninsight.com/2018/12/05/nato-approves-membership-action-plan-with-bosnia-12-05-2018/> Qasur me 24 nëntor 2020

¹³ Ky kriter është i pranishëm në PVA për Bosne e Hercegovinën

¹⁴ NATO, Forca e Sigurisë së Kosovës tanimë e vetqëndrueshme https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_101890.htm Qasur me 21 nëntor 2020

¹⁵ Për më shumë shih https://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_37750.htm